



Projekt: Përfshirja e grave të bashkësive etnike në tregun e punës



Shkup, 07.11.2016

THIRRJE PËR EKSPERTË/TE(profesionalistë)

Për mbajtjen punëtorive kreativ - edukative për fëmijë nga Manastiri

Inicjativa qytetare e femrave ANTIKO nga Shkupi dhe CARE Deutschland/Luxembourg e.V, shpallin thirrje për ekspertë/te lokale nga Manastiri të interesuar të angazhohen për organizimin dhe mbajtjen e punëtorive kreativ – edukative për fëmijë të moshës 5 deri në 10 vjeç.

Ekspertët do të angazhohen në kuadër të projektit „Përfshirja e grave të bashkësive etnike në tregun e punës,” financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga partnerët e proektit IQF ANTIKO dhe CARE Deutschland / Luxembourg e.V.

Punëtoritë kreativ- edukative për fëmijë organizohen në kuadër të projektit të lartë përmendur ku aktiviteti kryesorë i është dedikuar grave (nënave) nga bashkësitë etnike, të cilat duan t'i rrisin kapacitetet dhe potencialet e tyre për inkuadrim aktiv në tregun e punës.

Qëllimi i përgjithshëm i punëtorive është: fëmijët e nënave që i ndjekin trajnimet për fuqizimin ekonomik të grave të bashkësive etnike të jenë nën kujdes (në kohën kur nënat e tyre i ndjekin trajnimet). Kujdesi i fëmijëve realizohet nëpërmjet të organizmit/mbajtjes së punëtorive interaktive/gjegjësisht kreativ edukative, përmbajtja e të cilëve do të jetë e dizajnuar të jep përgjigje adekuate moshës dhe nevojave të fëmijëve.

Qëllimet specifike të punëtorive kreativ edukative janë: Të inkurajohen fëmijët për të shprehur potencialin e tyre krijues, me qëllim që në vazhdimësi të zhvillohen shkathësitë motorike gjatë kryerjes së punimeve(veprave/ proektmeve) të tyre individuale ose dhe ekipore.

Përmbajtja e punëtorisë edukativo- kreative: Përmbajtja e punëtorive edukativo-kreative duhet të synojë nxitjen e kreativitetit tek fëmijët, në mënyrë që të ndihmojë zhvillimin e aftësitë njohëse të tilla, sic është matematika dhe të menduarit shkencor. Të menduarit kreativ duhet të përfshijë aktivitete që do të japin kontribut në zhvillimin e : imagjinatës, përdorimin e metodave bazike, komunikimi, shkathësi fizike, përpjekje për detektimin e interpretimin e problemit dhe zgjidhjen e tij, si dhe përdorimin e simboleve që do të ndihmojë zhvillimin e mëtejshëm të aftësive, varesisht nga moshja dhe interesimi i tyre.

Punëtoritë do të organizohen për grupe moshe 5-10 vjeç, me preardhje të ndryshme etnike. Grupi do të formohet maksimum prej 25 fëmijëve.

Projekti do të sigurojë materialet e nevojshme për punëtoritë, lokalin dhe ushqimin për fëmijët.

Përshkrimi i detyrave

Në fazën e parë është planifikuar që ekspertët të jenë të angazhuar në një afat prej 8 ditësh në organizimin dhe mbajtjen e punëtorive edukativo- kreative, për fëmijët të moshës 5 deri në 10 vjet (që do të zhvillohen paralelisht me trajnimet e organizuara për nënat e tyre). Me mundësi që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në fazën e dytë të projektit.

Projekti do të sigurojë materialet e nevojshme për punëtoritë, lokalin dhe ushqimin për fëmijët.

Korniza kohore e organizimit/ mbajtjes së punëtorive

Periudha kohore : prej Nëntor 2016 - Janar 2017.

Kontrata dhe kompensimi për ekspertët: Kompensimi do të realizohet pas përfundimit të angazhimit. Eksperti/ja gjatë aplikimit duhet të paraqes një ofertë financiare që do të përfshin



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



ЖЕНСКА ИНИЦИЈАТИВА
ИНИЦИЈАТИВА QYTETARE E FEMRAVE



Projekt: Përfshirja e grave të bashkësive etnike në tregun e punës



shumën bruto të angazhimit (shumën neto të angazhimit, tatimin personal dhe transportin lokal nëse ka nevojë)

Përgjegjësitë specifike të angazhimit:

- Përgatitja e propozim programit dhe permbajtja e punëtorive kreativ –edukative
- Realizimi i punëtorive;
- Evaluimi i punëtorive të realizuara;
- Përgatitja e raportit të shkurt ditor dhe përfundimtar që përfshin vlerësimin e rezultateve të puntorive, si dhe rekomandimet e mundshme për të ardhmen.

Kualifikimi i duhur

Eksperti duhet të ketë kualifikimet dhe aftësitë e mëposhtme:

- Fakultet –shkollë e lartë (drejtim pedagogjik, ose pedagogji psikologji);
- Përvojë në organizimin e punëtorive edukativo kreative për fëmijë,, qasje metodologjike e përshtatshme për moshën e tyre;
- Përvojë e mëparshme me punë me fëmijë të etniteteve të ndryshme;
- Njohuri të shkëlqyeshme të metodologjive bashkëkohore pedagogjike dhe psikologjinë fëmijnore;
- Njohja e një nga gjuhët e komuniteteve pakicë, do të jetë përparsi.

Dokumentacioni i duhur

Oferta duhet të përmbajë:

- Propozim financiar i shprehur në denar;
- Draft Programi për punëtori;
- Biografi e detajuar (CV);
- Letër motivimi;
- Lista Referencë e trajnimeve të mëparshme, të cilat duhet të përfshijnë periudhën e zbatimit, organizatori , grupi i synuar, tema (përshkrim të shkurtër).

Kriteret e përzgjedhjes

kriteret për përzgjedhjen e trajnerëve janë:

- Përvoja e mëparshme relevante në zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve;
- Cilësia e propozim programit të ofruar;
- Pajtueshmëria e propozimit financiar me buxhetin.

* Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në rrethin e ngusht të përzgjedhjes do të kontaktohen.

Afati i paraqitjes

Aplikimet me dokumentacionin përcjllës duhet të dorëzohen më vonë deri në **14 nëntor 2016** në postën elektronike: contact@antiko.org.mk dhe në antiko@t.mk.



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



ЖЕНСКА ГРАЃАНСКА ИНИЦИЈАТИВА
INICIJATIVA QYTETARE E FEMRAVE